

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-087/13

**Prishtinë,
12 nëntor 2013**

Në çështjen juridike të:

D.J

Pala ankuese/Pala përgjegjëse në kërkesë

kundër

S.D.N

Pala përgjegjëse në ankesë/Paraqitësi i kërkesës

Kolegji i Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjqtarët: Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit të EULEX-it, Willem Brouwer dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/171/2012 (lëndët e regjistruar në AKP me numrat KPA 45218, 45220, 45221 dhe 45222), të datës 24 tetor 2012, pas shqyrtimit të mbajtur më 12 nëntor 2013, mori këtë

AKTGJYKIM

1. Anulohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/171/2012 për sa i përket lëndëve të regjistruara me numrat KPA 45218, 45220, 45221 and 45222;
2. Hedhen si të palejueshme kërkesat e S.D.N e regjistruar në AKP me numrat KPA 45218, 45220, 45221 and 45222;

1. Çështjet procedurale:

- 1.1. Më 16 tetor 2007, S.D.N si paraqitës i kërkesës ka paraqitur katër kërkesa në Agjencinë Kosovare të Pronës (KPA), ku ka kërkuar konfirmimin e së drejtës pronësore ndaj:
 - një arë të klasës së shtatë me sipërfaqe prej 0.13.39 ha, ngastra kadastrale nr. 772;
 - një arë të klasës së pestë në sipërfaqe prej 0.20.01ha, ngastra kadastrale nr. 1278;
 - një arë të klasës së shtatë në sipërfaqe prej 0.11.44 ha, ngastra kadastrale nr. 1338;
 - një kullose të klasës së 6 në sipërfaqe prej 0.09.86 ha, ngastra kadastrale nr. 1595;Të gjitha këto ngastra janë në zonën kadastrale Gotovushe të Komunës së Shtërpcës në Gotovushë.
Tani e tutje këto ngastra të ndryshme do të jenë të bashkuara dhe do t'u referohet si: pronat.
- 1.2. KKPK-ja ka gjetur se kërkesat janë të bazuara.
- 1.3. Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar palës ankuese më 25 mars 2013.
- 1.4. Pala ankuese ka paraqitur ankesat kundër vendimit të KKPK-së në AKP më 8 prill 2013, që është brenda afatit prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 për Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale.
- 1.5. Ankesat i janë dorëzuar palës përgjegjëse në ankesë më 14 qershor 2013, i cili ka paraqitur përgjigjen në ankesa më 27 qershor 2013.

2. Çështjet faktike

Kolegji i Apelit i merr si fakte të provuara, të cilat janë vërtetuar nga KKPK-ja dhe nuk janë kundërshtuar nga palët.

- 2.1. Prona fillimisht ishte në pronësi të I.D. Që nga vdekja e gruas së tij në vitin 1964, I.D ka jetuar në bashkësi të përbashkët familjare me palën ankuese. I.D kishte vdekur në vitin 1985. Familja e palës ankuese ishte kujdesur për varrimin e të ndjerit I.D.
- 2.2. Në vitet 1968 deri në 1971, familja e palës ankuese kishte ndërtuar një shtëpi, pjesërisht në ngastrën 2144, ngastër kjo që po ashtu ishte në pronësi të I.D. Kjo shtëpi ende shfrytëzohet si shtëpi familjare e palës ankues.
- 2.3. Familja e palës ankuese e ka kultivuar si dhe e ka shfrytëzuar pa pengesa pronën deri në vitin 1964.
- 2.4. Me një vendim të Gjykatës Komunale të Ferizajt, të datës 24 dhjetor 1985, pala përgjegjëse në ankesë, mes tjerash, është shpallur si trashëgimtar i trashëgimisë së I.D.

3. Kontesti ligjor:

- 3.1. Pala ankuese ka kërkuar nga kolegji që të vendos për rishqyrtim të vendimit KPCC/D/R/171/2012 dhe ta shpall palën ankuese (bashkë-)pronar të pronës. Ankuesi e ka bazuar kërkesën e tij në deklaratën se ai e ka poseduar dhe shfrytëzuar pronën pandërprerë që nga viti 1964 e tutje. I.D ishte anëtar i familjes së ankuesit. Pala ankuese i referohet dispozitave ligjore të nenit 4 të Ligjit mbi Marrëdhënjet Themelore Pronësoro-Juridike dhe nenit 40 paragrafi 1 të Ligjit mbi Pronësinë dhe të Drejtat e Tjera Pronësore.

4. Arsyetim ligjor

Sipas detyrës zyrtare: Bashkimi i lëndëve

- 4.1. Neni 408.1 i Ligjit Nr. 03/L-006 të Procedurës Kontestimore (LPK) parasheh që gjykata mund t'i bashkoj të gjitha lëndët atëherë kur dy e më shumë procedura janë në zhvillim e sipër pranë të njëjtës gjykatë dhe në të cilat janë të përfshirë të njëjtët persona, nëse kjo do të siguronte efektivitet dhe efikasitet të lëndës.
- 4.2. Në lëndët e regjistruar me numrat: GSK-KPA-A-087-088-089-090 (**KPA 45218, 45220, 45221 and 45222**, faktet, bazat ligjore dhe çështjet faktike janë të njëjta. Vetëm ngastrat, lëndë e të drejtave proësore të cilat pretendohen në secilën kërkesë, janë të ndryshme. Ankesat bazohen në të njëjtat deklaratat shpjeguese dhe në të njëjtat dokumente. Prandaj, meqë të gjitha elementet e lëndëve janë të njëjta, përveç ngastrave është më efektive që të bashkohen ankesat dhe që ato të shqyrtohen në një aktgjykim të vetëm.

- 4.3. Lëndët e sipërcekura do të konsiderohen si një lëndë e vetme nën numrin GSK-KPA-87/13.
- 4.4. Sipas nenit 3.1 të Rregullorës së UNMIK-ut 2006/50 a amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhër nga Komisioni për riposelimin e pronës nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm dëshmonë pronësinë në pronën e paluajtshme private, por gjithashtu se ai ose ajo nuk mund t'i ushtrojë të drejtat e tilla për shkak të rrethanave që janë të lidhura direct ose që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhë në Kosovës midis 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999 (konflikti i armatosur)
- 4.5. Në vendimin e vet KPCC/D/R/171/2012, KKPK-ja ka konsideruar në paragrafin 10 se: *“(...) paraqitësi i kërkesës duhet të tregojë (...) se ai ose ajo nuk është në gjendje që t'i ushtrojë këto të drejta pronësore për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërsëdrejti apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.”* Në rastet e pakontestueshme, si rregull kjo do të merrej parasysht. Megjithatë, në përgjigjen e tij në kërkesën e palës përgjegjëse në ankesë, pala ankuese qartazi ka deklaruar:
“dhe për këtë (Ivković Drago) e ka lënë në shfrytëzim dhe në dispozicion të familjes Stevanović tërë pronën e tij, e cila e ka shfrytëzuar dhe kultivuar atë pa ndonjë pengesë deri nga viti 1964 deri me sot” Kjo është në kundërshtim të drejtpërdrejt me deklaratën e palës përgjegjëse në ankesë se ai e kishte humbur të drejtën pronësore si rezultat i konfliktit të armatosur.
- 4.6. As në kërkesën e tij në AKP e as në përgjigjen e tij në ankesën e palës ankuese, pala përgjegjëse në ankesë nuk ka deklaruar se i kishte ushtruar të drejtat e tij pronësore në periudhën ndërmjet dhjetorit të vitit 1985 (momenti i trashëgimit të pronës) dhe konfliktit të armatosur të lartpërmendur. Në fakt pala përgjegjëse në ankesë asnjëherë nuk ka deklaruar dhe as provuar nëse ai ka ushtruar të drejtën pronësore të tij.
- 4.7. Gjykatën Supreme konkludon se çështja nuk është në juridiksion të AKP-së dhe është dashur të paraqitet në gjykatën e rregulltë. Dhe për me tepër, KKPK-ja në vendimin e vet është dashur ta konsideronte kërkesën e palës përgjegjëse në ankesë si të papranueshme.

4.8. Pasi që çështja nuk është në juridiksion të Kolegjit të Apelit të AKP-së, vendimi mbi meritat duhet të merret nga gjykata kompetente.

4.9. Konkluzion

Gjykata Supreme vendosi që të anulojë vendimin e Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/171/2012 për sa i përket lëndëve të regjistruara me numrat KPA 45218, 45220, 45221 dhe 45222 dhe sipas detyrës zyrtare të hedhë poshtë kërkesat e palës përgjegjëse në kërkesë të paraqitura në AKP si të papranueshme. Meqenëse kërkesa e palës përgjegjëse në ankesë pranë AKP-ës është refuzuar sipas detyrës zyrtare, Kolegji i Apelit nuk ka shqyrtuar meritat e ankesës.

5. Këshillë ligjore

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Elka Filcheva-Ermenkova , Kryetare e Kolegjit, EULEX

Willem Brouwer, Gjyqtar i EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX-it